

Komuna e Mamushes
Data: 24.06.2020
Mbledha e 05 e Rregullt e Asamblese Komunale
Vendi: Mamushë

| | | |
|---|--|--|
| Republika e Kosovës-Kosova Cumhuriyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo Mamuşa Belediyesi-Komuna e Mamushës Orština Mamuše-Municipality of Mamusa |  |  |
| Çıkış - Dalëse - Izlazna - Outgoing | | |
| 01 | No.Nr. | 064 - 20 |
| Tarih/Dt. 30.06.2020 | | |

PROCESVERBAL

Mbledha e 05 e Rregullt e Asamblese Komunale është mbajtur me datë 24.06.2020

në ora 10:00 ne sallën e Asamblesë Komunale.

Mbledha është udhehequr nga Kryesuesi i Kuvendit Z.Buyar Mazrek.

Në mbledhje kanë marrë pjesë 14 anëtarë

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë të Asamblesë, të nderuar misafirë mirë se erdhët në mbledhjen e 05 të rregullt të Asamblese Komunale për vitin 2020. Mbledha është mbajtur në ora 10:00.

Rendi i dites:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i KAB-it për vitet 2021-2023
4. Shqyrtimi dhe miratimi i nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit për strehimoren e Prizrenit
5. Të ndryshme.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë , a ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal?

Ilyas Bayraktar:

Përvendetje për të gjithë, sa i përket procesverbalit, procesmbajtësi duhet ta nënshkruajë atë .

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë , a ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal, nëse jo atëherë votojmë.

-Po 14
-Jo 0
-abstenim 0

Me vota unanime prosesverbal u pranua.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diqka me shtu në rend te ditës nëse jo atëherë votojmë.

Me vota unanime rendi i dites u pranua.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i KAB-it për vitet 2021-2023

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diqka me shtu rrreth kësaj pike?

İlyas Bayraktar:

Ju pëershëndes tëq gjithëve, sa i përket KAB- it disa pika na ka tërhjekur vëmëndjen, kishim dasht me pyt edhe Kryetarin nashta na kish dhënë sqarime. Buxheti për vitin 2020 është 1,968,888,00€ dhe si ka mundësi që në vitin 2021 ky buxhet të bie në 1,688,000€ cilat janë arsyet. Në zyrën e kryetarit për vitin 2020 janë planifikuar 100,000€ dhe si ka mundësi që në vitin 2021 dhe 2022 të jetë 124,000,00€ kurse në vitin 2022 kurse numri i stafit i njëjtë. Qështja e tretë është tek zyra e kuvendit , stafi është 0 kurse ne shumë mirë e dijmë që ju e keni afër një asistent. Në vitet 2020-2021-2022 me 0 numër të stafit nga mallrat dhe shërbimet janë planifikuar 5,500,00€ a janë paraparë për këtë . Në shërbimet sociale dhe në kulturë dhe rini është vetëm një staf janë paraparë 6,831,00€ paga dhe nëse pjestohet për 12 muah atëherë paga e zyrtarit po del 569,25€ pra gati më e lartë se e drejtorav. Pres sqarime prej juve. Faleminderit.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Ju pëershëndes të gjithëve, ishalla sa më shpejtë e tejkalojmë problemin me Covid- 19. Sa i përket virusit në Mamushë kohëve të fundit ka rritje të nurmit të rasteve. Ana negative e virusit ishte tendenca për mos deklarim të virusit për shkak të thashethëmeve por ana pozitive tani për tani e virusit është që mbrenda dy javëve të fundit paacentët e sëmurë kanë filluar të kërkojnë zgjidhje. Gjëja më e keqe për neve është që për shkak të thashethëmeve të këqija pacientët e sëmurë në shtëpi kanë pasë frigë me shku në spital por shqyr prej zotit kohëve të fundit numri i të sëmuarve ka rënë, ata që janë të sëmurë ngadal ngadal po shëndoshën dhe ishalla sa ma shpejtë kthehen në shtëpitë e tyre. Sa i përket pyetjeve te İlyazit, nëse ju kujtohet kur ju kemi dërguar buxhetin ka qenë një tabelë e vogël. në Qarkorën 1 buxhetore rrëth 1,968,00€ i kemi miratuar për vitin 2020, ndërsa buxhetin që na e kemi kërkuar për vitin 2021 është 2,627,681€. Sa i përket zyrës së kuvendit, bazuar në ligjet e kosovës dhe rregulloreve të nxjerra nga MAPL, është e caktuar numri i zyrtarëve që nuk e kanë statusin e zyrtarit që do të punojnë në zyrën e kryetarit dhe në zyrën e kuvendit. Ne prej aty po mundohemi të paguajmë pagën e asistentit të kryesuesit plus në ndërkohë kur po ka ndonjë drekë zyrtare ose ndonjë obligim tjetër të zyrës mjetet po i marrin nga kjo zyrë. Shkaku i paqyrimit pagave të larta për vitin 2020 është sepse planifikimi i pagave është bërë bazuar në vendimin e fundit që e ka marrë kuvendi i kosovës. Ka me pas rritje të pagave tek Drejtorët, pra nëse hyn në fuqi ligji i pagave do të na duhet ky buxhet. Ne kemi bërë planifikimin e pagave me supozimin që do të hyjë në fuqi ligji i pagave. Përveq kësaj edhe ne planifikimin e projekteve infrastrukturore qëllimi më i madhë i joni është me u posued me kode të projekteve. Për vitin 2021 janë të planifikuara 876,197€. Sipas qarkores buxhetore 1 për shkak të mungesës së 48 nxënësve kemi 208,000€ buxhet më pak. Krahasuar mme vitin 2020 në vitin 2021 është paraparë një buxhet më i vogël. Ne normalisht jemi në kontakt edhe ministrin e Arsimit edhe me ministrin e shëndetësisë. Sa i përket shëndetësisë ne jëmi duke luftuar për dy qështje, e para ndërtimi i ndërtësës së QMF-së, pra si ta shfrytëzojmë buxhetin sa më mirë për këtë dhe e dyta QMF-në me shëndrru në QKMF. Nëse e marrim statusin e QKMF-së atëherë aty duhet me qenë një drejtor, njësia për menaxhimin e financave si dhe duhet të hapet edhe njësia e emergjencave. Qëllimi jonë në kryesor është me fitu statusin e QKMF-së dhe nëse këtë e realizojmë atëherë ne e kemi një buxhet të planifikuar prej 198,151,00€. Kërkesa jonë është 198,151,00€, këto mjete nuk mjaftojnë vetëm për paga e ku janë pagesat për shpenzimet si rryma, mbeturina, ndërrimet e natës etj. Ne kemi bërë një planifikim prej 498,924,00€ . Përveq kësaj 4,000,00€ i kemi vendosur për pajisje speciale mijeksore gjithashtu edhe 10,000,00€ i kemi vendour per pajisje speciale mijeksore tjera, 100,000,00 i kemi kërkuar për ndërtësën e QMF-së. 55,000,00€ i kemi kërkuar për bashkëfinancimi i projekteve me donator. Pagat i kemi planifikuar sipas ligjit te pagave. Në zyrën e kryetarit zyrtarisht janë duke punuar 10 zyrtarë por përveq kësaj bazuar në rregulloreve që u janë dhenë kryetarëve të komunave, kryesuesit të kuvendit dhe nënkyrjetarit unë si kryetar i komunës nuk kam dashur me i zënë vendet e punës me staf politik, për këtë arsyet kam hapur konkurs dhe iu kam dhënë hapsirë të diplomuarve. Shkaku i daljes së pagave të larta është për arsyet se është marrë për bazë ligji i ri i pagave nëse do të hyjë në fuqi. Edhe në projektet infrastrukturore ndoshta e keni parë kemi një buxhet prej 30,000-40,000€ por kjo është në bazë të qarkorës 1 ndërsa kur të na vjen qarkorja e dytë buxhetore

është përfundimtarja dhe atëherë ne të gjithë së bashku ulemi dhe vendosim se qka është më e mira për projektet e Mamushës. Faleminderit.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit

Faleminderit Kryetar, urdhëro Halim.

Halim Sadiku:

Së pari ju përshëndes të gjithëve, unë deshta vetëm mu nal te investimet kapitale për vitin 2021-2023. I pash do thuajse gati kopje Z. Kryetar, kopje te vitit te kaluar, un e di që lëvizin kjo projektë ama nuk lëvizin aq sa menojmë, nuk ka detaj. Pot ndalemi shembull tek riparimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe kanaleve 30,000€, domethënë kjo shumë është tepër për mirëmbajtje. Domethënë nëse kalon kjo shumë është jashtëzakonisht shumë për shkak se 30,000 qka kena me mirëmbajt na me 30.000€. Nuk po tham te asfaltimi 50.000€ pra per rrugën e Smaqit ajo është e jashtëzakonshme, ajo është mi8rë/ Tani ki kanalizim prap 30.000€, qka domethënë kjo, domethënë mirëmbajtja po kushton sa investimi , kjo është diqka që ose unë nuk po mundem me kuptu ose keni gabu ju.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Oka kuption ti me mirëmbajtje?

Halim Sadiku:

Unë me mirëmbajtje kuptoj në qoftë se zihet dhe ka nevoj me intervenu diku, qekjo është mirëmbajtje. Investimi me mirëmbajtjen e ka një shumë, kur mirëmbajtja banvaki me 2,000-3,000€ kalon. Ska qka me mirëmbajtë sepse nëse aj nuk ka pad edhe nuk ka ku me shku qka doni me mirëmbajt aty. Domethënë këtë pe shog shumë gabim. Investinme te ndërtesa e re shkolles fillore 100,000 €. Renovimi i shkolles 10,000€. Ti e marove shkollën edhe prap u ktheve 10,000€ e rinovove. Unë edhe prej drejtoret te financav e kum lyp një raport të detajum, sa metra kanalizim janë vendos, sa shtylla elektrike, sa metra lkabllo nëntoksore ajanë vendos, këto të paktën le ta lyp drejtori prej menaxherëve. Mujna mi hek shumë projekte tjera edhe me bo ni projekt taman. Tjetra nuk ka të planifikum një stazë ecje me ndriqim, me ulëse, ju e dini se kudo në botë ka mbi peshë. Ti je kryetar komune edhe duhesh me planifikoi kto, me menu se ku do me lëviz qytetari, a dot ketë siguri në qoftëse lëviz nëpër asfalltim, a i ke siguru ecje, a i ke siguru vende për pushim sepse kemi vende të mjaftueshme për ketë. Kështu që pres në të ardhmen me ndryshu. Faleminderit.

Buvar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit

Faleminderit Halim, urdhëro İlyaz.

İlyas Bayraktar:

Siq e ceki edhe kolegu më herët 10,000€ për renovim të shkollës janë pak bile sepse nëse në shkollë vijojnë mësimin 1000 nxënës dhe dëmi i shkaktuar nga këta nxënës nuk mund të mbulohet me 10,000€. Veq une nuk po mundem me kuptu diqka, këtu është paraparë një projekt Kabllo elektrike nen toke në vlerë prej 100,000€, per vitin 2021, në cilën pjesë është paraparë, në gjithë Mamushën apo vetëm një pjesë e Mamushës. Qeshtja tjetër eshtë tek projekti i Sistemi i ujitjes fushes, në vitin 2021 dhe 2022 nuk është paraparë ndërsa në vitin 2023 kur nuk është kryetari është paraparë. Qështja e tretë eshtë tek projektet Ura dhe muri mbrojtës i Lumit Topllua dhe Projekti i shtreses e gurit te shtratit lumit Toplluva, qështja e tjetër eshtë tek projekti Asfaltimi i rrugës Smaç dhe ura e re, aty është një urë dhe nuk ka nevojë për urë të re, a ne nuk po dijmë épë do të hapet një pjesë tjetër. Kisha dashur që të ofrohen sqarime rreth qështjeve të lartëcekura. Faleminderit. Përveq kësaj nuk është ndërmarrë asnjë për Covid-19 për vitin 2021. A thua në vitin 2021 gjithqka do të jetë në rregull me virus, këtë nuk po mundem me kuptu.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit

Faleminderit İlyaz urdhëro Kryetar.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Po filloj nga qështjet që i ceki Halimi. Mirëmbajtja e rrugëve dhe kanaleve, ky projekt përfshin rërën, kubëzat, asfalltimin, punët me bager. Më së paku 4 -5 herë e kemi pastruar pjesën mbi zjarrfikësa dhe kostojta e një pastrimi kushton deri 5000€. Sa i përket kanaleve, në disa lagje janë vendosur kanalizime të reja. Sipas meje 30,000€ pér këtë projekt janë pak bile. Ndërsa pér projektin e Kabllo elektrike nëntokësore ne jemi datuar disa herë me KEDS- in dhe i kemi propozuar që ne si komunë e Mamushës mbrenda mundësive që i kemi ti hapim kanalizimet pér projektet infrastrukturore por lidhjet me i bë ju por nuk kemi mundur me ardhë në një situatë të tillë sepse KEDS-i po thot që nuk është projekt i rajonit të dukagjinit pér këtë vit, pas këtij viti më së tëpërtimi do të investojmë në këtë rajon. Sa i përket ndërtëses së shkollës ishalla këtë vit do të fillojmë me ndërtimin e objektit, kemi buxhet prej 198,000€, ne i kemi kërkuar 100,000€ dhe sipas takimeve që i kemi zhvilluar me Ministrin e Arsimit kur të nënshkruhet marrëveshja kur te dalim në render pér projekt shuma e cila nuk mjafton do të mbulohet nga Ministria e Arsimit. Ka ndryshuar qeveria, është anuluar edhe projekti bile edhe zotimin e ka anuluar. Sa i përket mirëmbajtjes së shkollës ne këtë vit jemi duke pritur me nënshkru marrëveshje prej 14,000€ me IOM-in si dhe ne i kemi ndarë 10,000€ pér këtë projekt. Kanë me u ndryshu dyert e klasave, problemi me ndriqim, qeshmet kanë me u rregullu. Projekti është i hartuar dhe jemi duke u munuar që të vendosim dyer prej alumini, pra dyer që janë më të qëndrueshme. Rruga e Samqit, këtu ka një gabim teknik, hartimin e projektit e kemi bërë më herët. Në bazë të takimit që e kemi bërë vitin e kaluar me komunën e Prizrenit, ne i kemi thënë edhe Mytahirit edhe drejtorit të Infrastrukturës qëq në si komunë kemi mjete pér hartim të projektit por jo pér asfaltim. Ishte fundii vitit dhe ka pasur disa mjete rezervë ku së paku kishim mundur bile urën me përfundu. Deri tek qeshmja janë kufisjtë e territorit të Mamushës, pas qeshmës është territor i Prizrenit, pasi që të gjitha investimet që i takonin territorit të komunës ne këmi propozuar që edhe të lidhim ortakëri. Ndoshta ju kujtohet vitin e kaluar kemi mbajtur mledhje të jashtëzakonshme pér qështjen e bashkëpunimit me komunën e Prizrenit pér projektin në vlerë 300,000€, kkomuna e Prizrenit pér shkaqe të mbrendshme politike nuk e kanë votuar dhe ky projekt është anuluar. Këtë vit sipas takimeve që i kam zhvilluar me Mytaher Haskukën na ka thënë që kemi me qenë në gjendje me shtru asfallt ama sa është e vërtetë nuk e di. Së fundi pér neve më e rëndësishme është posedimi me kodet e projekteve. Kur kërkojmë projekte prej ministrive po na kërkojnë edhe kodin e gatshëm dhe nëse e kemi kodin e gatshëm mjetetet po i fitojmë me kohë. Shumica e ministrive qështjen e hapjes së tenderëve po i delegon komunave sepsë po ta bënte vetë ajo i ka kodet, komuna nëse nuk i posedon këto duhet ti hap në ministri të financave ose nëse eka kodin procesi përfundon më shpejtë. Siq e thashë edhe më herët ministria na ka ofruar 1,968,888,00€ buxhet kurse ne po i kërkojmë 2,625,000,00€. Këtë vit do të kërkojmë edhe përkrahje nga deputetët, deputetët e KDTP-së janë anëtarë të komisionit pér buxhet dhe financa. Vitin e kaluar ne këmi hapur një kuadër prej 16 personave, e kemi bashkangjitur përkrahjen e projektit në vlerë 600,000,00€. Pasi që është qarkorja e parë buxhetore kjo më një fjalë është buxhet i kërkuesave por qarkorja e dytë buxhetore është buxhet i prerë dhe nuk mundemi me dal përtej saj. Këto janë qështjet që unë jam mundu me u përgjigj.

İlyas Bayraktar:

Po tek muret që ju pyeta më herët.

Abdülhadi Krasnici: Kryetar i Komunës

Njëri mur është për urën e re ndërsa tjetri mur është për urën ekzistuese. Një projekt ka shku ura së bashku murin, i kanë pasur kodet e vetra, projektet me kodet e gatshme po kalojnë më lehtë në Ministri, njëri është ura së bashku me mur ndërsa tjetri është vetëm për urë. Nëse mundemi me rrit buxhetin atëherë murin duhet me vazhdu deri tek shtëpitë poshtë she duhet me ndërtu një urë. Por kur të na vjen buxheti më pak se që e kemi kërkuar atëherë do të ulemi së bashku dhe do ti shikojmë projektet më priotare. Sa i përket Covid -19 asnjë komunë nuk ka bërë asnjë planifikim, ne kishim mundur me bë

ndonjë planifikim po ta kishim pasur buxhetin në vlerë prej 3,000,000 apo 4,000,000 €, i kishim thënë ndërmarrjeve që Mamushë që përderisa zgjat pandemia mbyllni ndërmarrjet dhe tërë fitimin që e keni humbur ua kompenzojmë ne, por një mundësai të tillë nuk e kemi. Na nuk kemi kompetenca për me i mbyll ndërmarrjet, kompetencën përfutje në karantinë i takon vetëm qeverisë. Faleminderit.

Halim Sadiku:

Inderuar zoti kryetar, e keni vërejtjen tek projektet me bashkefinancim, qka do që të thush ky është projekt edhe ti e ke projektu qeto me nënkyretart e tu, me drejtorë. Qeky 20,000€ a sosht pak në qoftëse ty yë ofrohet një financim jasht qka mujsh me bashfinancu. Sa herë e kemi cekë që qdo projekt e ka kodin e vet, pse nuk bohet pëershembull edhe emërtimi i projektit. Kisha kerku në të ardhmen e, që ta bani edhe kodin mase ta bani kodin ta bani edhe emrëtin, ban projekt të detajum, se nuk jam i interesum me fol ket punë hiq mo, po pritoj edhe me fol mo/ Po ti qka po pret a po pret, na po thojmë bane queshtu ti prap pe vazhdon sipas kokës tënde. Përgjigjna se na jena legjislativi, na mujna qetash me na u mush menjë si kalojmë hiq, del problem, jo qe ti smundesh me i vazhdu projektet, i vazhdojsh deri në atë masë ku vazhdohen dikur edhe ti has në penges. Kështu që pres prej teje në vitin 2021 me bo mas sodit edhe qka financohet, projekte të detajume. Faleminderit.

Abdülhadi Krasnić: Kryetar i Komunës

Halim 20.000€ janë pak, por pas miratimit të buxhetit pra pas miratimit të projekteve duhet një nga një të hartohen projektet. Shembull për shëndetësi ministria ofron 100.000€ përkrahje, do ta hartosh një projekt prej 100.000€ kurse tenderi po fitohet me 40.000€ ose 50.000€, mjetet tjera pra 50.000€ po mbresin. Ne po thojmë që ne do të kontribojmë me 1000€ kurse ju ofrona 100.000€, kurse në fakt e din që kur po del në tender ajo po shkon 50.000€. Këto mjete prap po na mbresin neve, nuk po shpenzohen. Situata në Kosovë është kështu, sa është mesatarja e shumës së tenderëve të hapur edhe sa e marrin operatorët ekonomik, rrëth 30% deri 40% më lirë shkon. Një projekt prej 100.000€ maksimum e jepin për 60.000€. Me të vërtetë 20.000€ janë pak për bashkëfinancim, nëse ofron dikush përkrahje prej 100.000€ në Mamushë gjë që sma merr menjë që do të ofron dikush një përkrahje të tillë në Mamushë sepse së fundmi të gjithë e dini që gjithë po punojnë në favor të votave. Investimin që ka me dhënë në Prishtinë kurrë nuk e jep në Mamushë sepse në Prishtinë do tio merr 50.000 vota kurse në Mamushe i merr 50 vota. Siq e thashë edhe më herët 20.000 Euro janë pak por kjo është qarkorja e parë buxhetore, kur të na bijnë qarkorën e dytë buxhetore atëherë nuk kemi mundësi me bë asnjë lëvizje. Pasi të na sjellin kornizën e dytë me projekte përfundimtare atëherë vitin e ardhshëm ne do të dalim me projektime. Sipas ligjeve ne Kosovë nëse don me dal me ndonjë tender duhet me qenë projekti i detajuar dhe të gjitha këto procedura po marrin kohë. Faleminderit.

İlyas Bayraktar:

I nderuar kryetar pak më herët thatë që na nuk kemi kompetenca me i mbyll ndërmarrjet publike, kjo është në rregull, por qka keni ndërmarrë ju si kryetar për parandalimin e pandemisë. A ju ka ardhur ndonjë shkresë nga Ministria që në familjen X ka Xpersona të infektuar, ndoshta në atë familje nuk mundemi me ndërhy por të paktëm mos me i leju me u grumbullu. Me sa e di ju jeni duke e ushtruar detyrën e kryetarit të shtabit të emergjencav. Në një fabrikë prej 150-200 metrash në minibusin prej 8 personave po hipin 12 persona. Ndaj këtyre mundesh me marrë masa, ministria nuk ta ndal ty me shku nëpër lokale edhe me shiku a po mbajnë distancë, a kanë pastërti. Ju lutemi neve bile mos na bëni politikë sepse na i dijmë dhe i kemi kalu të gjitha. Edhe punonjësit shëndetësorë të cilët kanë rezultuar pozitiv me virus nuk po kujdesen fare, nëse ai mjek apo infermier i cili ka rezultuar pozitiv e kërcenon shëndetin e tjetrit atëherë më vjen shumë keq Kryetar ama ne kërkojmë llogari nga ju. Kryetar ju lutem mos keqkuptoni ama me pretendimin që do ti merrni dy apo tri vota më tepër mos e vëni në rrezik shëndetin e qytetarëve. Ndoshta nuk mundemi me i ndalu disa gjëra por të paktën me i ndalu tubimet. Nëse kuvendi merr vendim atëherë edhe ne do të veprojmë më lehtë. Kjo është një sëmundje dhe nuk është turp, më e rëndësishmja është që me tejkalu këtë virus me pak dëmtime. Unë kisha kërkua prej juvë që nëse pandemia do të vazhdojë akoma në vitin 2021 të ndahet buxhet dhe të sjellim 5000 teste në Mamushë, nëse jo 5000 atëherë 3000. Kush ka simptoma le ti nënshtronhet testit. Përveq kësaj edhe kryesuesi ka

shkuan në QMF duke bërtitur, ju lutem mbani pak qetësi dhe kujdes. Unë po them që kafiteritë dhe ndërmarrjet mos të mbyllen por vetëm le të mbajnë distancë, le të mbajnë higjienë.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Îlyaz kush dhe qka kanë thënë ndaj meje është gabim, un as nuk kam shkuan me shkaktu zhurmë në QMF as nuk jam kacafyt me askënd. Veqse nëna ka qenë e sëmurë dhe mjeku më tha që po dyshij tek nëna përvirus, unë i thash që nuk keni nevojë qka me dyshu sepse nëna ime ka sëmundje tjera, 3 herë ka pas ndërrhyrje në zemër, as që e kam hapur gojën ndaj askujt. Kur shkova në shtëpi vajza dhe gruaja më thanë ti si mundesh me mbyll QMF-në dhe ti marrësh dokumentet.

Halim Sadiku:

Inderuar zoti kryesues, nuk është pika e rendit të ditës këtu e covidit por është e planifikimt të buxhetit, të ndryshme mujna me fol përkthimtë temë sa të doni, mbanë pak rendin. Zoti kryetar a keni planifikimt përqeshjen e ujit, unë nuk pe shoh kërkunë në asnjë vit, në 2022 ti nuk je kryetar komune. Që keni bo edhe me ato që keni shpëtuar përsimbull kur e keni dit edhe uj që ska, ujë që nuk pihet, mirë keni bo edhe që nuk keni planifikimt se kur ta kqyrish me ni anë shpëtuar uji ssihet domethën veq me hargju pare kot. A do të planifikoni, ka do të lidheni me ujë të pjesës, a keni bisedu me najkan, qysh do mu furnizu ky popull me ju dmth kisha desht nje per gjigje prej juve, po edhe nëse kena me pas nuk do të mujna me menaxhu, dojnë analiza e disa procedura tjera. Na jena kon me hidroregjionin e Gjakovës, qdo 30 minuta bahet analize e na nuk mundemi me bo atë. Edhe nëse e furnizon Mamushën prej naj deponie prap at ujë nuk mundesh me quajt ujë të pijshëm. Kjo don planifikim, kjo është ma urgjente qytetarët të kanë votu ty si shërbyses i tyre dhe nëse krejt ta bojn rrafsh ty kryetar unë nuk ta baj, jo ty po as kerkujt tjetër. Qytetarët e Mamushës janë të zhgënjam me ty jashtëzakonisht, cila është arsyesa dil pyti ata. Rrugët nuk i ki në rregull, kanalizimet nuk i ki në rregull, parqet nuk i ki në rregull. Dil lype defektin te ti, a eshtë që nuk pi jepish kompetencia drejtore mjaftueshëm edhe duhesh mi majt krejt senet nen kontroll. At ty nuk vijnë met thon ama po ma thojnë mu, unë po ta interpretoj ty për qe ti mu përmirësu, ti me punu. Unë nuk ta baj mas shpine, dije qe unë jam i prin që me tkqyr në sy edhe me ti thon. Prej meje mos u tut që veproj diqka prapa shpinës tënde. Qeky planifikim është i dobët, ky është copy-paste. Faleminderit.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Sa i përket ujit janë shpuar puse, analizat e ujit janë bërë mandej doli problemi me virusin dhe qe 4 muaj ujmësitet kanë mbetur në Mamushë, disave iu janë kyqur ndërsa disa nuk kanë pranuar. Pusi i parë është hapur dhe ne si komunë për ujë të pijshëm nuk kemi shpenzuar as edhe një cent por ndërmarrja që e ka marrë përsipër këtë qështje e di që afërsisht ka shpenzuar 500,000,00€. Ne Novakë është hapur një pus dhe ka dalë uji i gjallë nga aty, është hapur edhe pusi i dytë dhe analizat e këtij uji të pusit i ka marrë Instituti shëndetësor i Kosovës dhe ia deleguar ndërmarrjës përkatëse dhe sipas rezultateve të ndërmarrjes uji është i pijshëm. A mjafton apo nukmjafton uji mvaret nga keqpërdorimi jonë. Larte depoja e ujit është pastruar, janë rregulluar 54- deri 56 dëmtime, do të ndërrrohen ujëmatësit dhe pas ndërrimit do të kyjet uji. Komuna e Mamushë së bashku me komunën Prizrenit, Suharekës, Malishevës dhe Dragashit janë të uji. Komuna e Mamushë mund ta filtrojë ujin në një fabrikë në Prizren e cila është ndërtuar me një fundit Komuna e Mamushë mund ta filtrojë ujin në një fabrikë në Prizren e cila është ndërtuar me një teknikë të fundit dhe e cila asnjëherë nuk është aktifizuar. Gypat e ujit janë shtrirë deri në Novakë ndërsa prej Novakës deri në Prizren po nevojiten 11 km gypa, 400,000,00-450,000,00€ buxhet plus 300,000,00€ më tepër një makineri duhet pra afér 800,000,00€ buxhet duhet përkthimt projekt. Buxheti i Kosovës akoma nuk është miratuar dhe komuna ashtu ashtu nuk ka buxhet pra jemi duke punuar pa buxhet. Unë asnjëherë nuk them që si kryetar i komunës jam perfekt, i kam edhe anët negative, kemi edhe gjëra që nuk kemi mundur ti realizojmë, edhe dihen cilat janë ato, nuk do të thotë që punët që po i bëjmë janë 100% në rregull. Qdo herë po mundohemi që të kryejmë punë, nganjëherë po mundohem vetë nganjëherë me përkrahjen dhe propozimin e qytetarëve. Mamusha qdo herë ka nevojë për investime, unë vazhdimisht po them që nëse do të kishte qenë mundësia me e qu Mamushën 10 metra lartë dhe me instaluar rrumbë, ujin, kanalizimin dhe prap me lëshu poshtë. Mirëmbajtja e rrugëve shembull 60% e rrugëve janë prishur, kanë

kaluar kamionet mbi rrugë, janë dëmtuar kubëzat dhe në vend që të rregullojmë rrugë tjetra ne po mirremi me renovime të tyre. Faleminderit.

Halim Sadiku

Inderuar zoti kryetar, Mamusha dihet domethënë është shumica prej komunitetit turk edhe une nihna krenar që jam i mamushës. Per investimet ne manushe pak e ke ngrit qështjen, pak e ke bo mediative se pse mamusha është një vend me industri të bujqësisë së zhvillume. Ndash në kërkim të ujit ndash në kërkim të ndihmave unë nuk pot shoh në media. Po të ishtë një kryetar tjetër me këtë trend zhvillimi të bujqësisë që është mu ma merr menjë që kish me bo shumë ma shumë. Maspasi qka ke bo për buqjt e Mamushës, absolut sen, a e ki naftin barabartë si qyteti si fshati. Direkt është dashur me kërkua prej ministritës së bujqësisë naft me qmim të veqnatë për buqjt, bile bile 3 cent ose 5 cent.

Abdülhadi Krásnic: Kryetar i Komunës

Po unë e kam nënshkru kontratën dhe qdo bujk mundet me shku ama duhet jasht Mamushës me shku se nse në Mamushë nuk ka.

Halim Sadiku

Kështu që unë kërkoj prej teje shume ma shumë për shkak se jem një vend me ma shumë prodhim në Kosovë dhe e meritojmë. Pse mos me pas sera moderne, me lyp një fabrikë të domateve prej qeverisë, me bo digka. Faleminderit.

Nehat tac

Ju përshëndes të gjithëve, Halim pasi që e hape qështjen për domate edhe ish kryetari disa here ka fol edhe kryetari i ri por shumë leht na mundemi me bo fabrikë industriale po domate ku me marr tanë. Sezon na e kena 3 mujorin, ma tepër nuk kena po domate përpunimi ku dush me marrë. Këtë domatën na që e mjellim është e freksët për në treg. 7 cent me qu kg te abi duhet 11 kg domate për me bo 1kg ketqap ose salce. Kjo domate nuk bënë. Edhe i thaë kryetaarit qka bane ti për bujxit. Na kemi pas edhe ish kryetarin të cilin nuk po du me ofendu, na presim edhe këtë vit edhe sipas bisedave që i kemi bo na ka premtu që ka me infestu edhe ni herë maksimum për prodhues. 400.000.00€ kush i nxori para dy vite per kompenzim të dameve. Kur hini në iniciativë ky unë personalisht i kam thënë mos hyn sepse nuk mundesh me i nxerrë, ‘sh kryeministri Ramush Haradinaj ka qenë në vizitë në Krushe te madhe sun morën edhe aty ka bo 1.000.000.00 € dëme. Faleminderit.

Ilyas Bayraktar

Komuna dhe kryetari nuk munden me hapë fabrika, kryetari mundet me ofru kushte por edhe Mamusha nuk ka vend. E dyta sa i përkey naftyës që tha KRYETARI 5% zbritje për bujqit por kur ta llogarit 5centi është më i shtrenjtë se gjërat normale tjera. Janë 5 zyrtarë komunalë që nuk janë bujq dhe që figurojnë në atë listë të zbritjes. Po ndalem tek ju Z. Nehat, ju jeni kryetar i shoqatës dhe po habitem me juve se si po thoni që ku të marrim domate. Nëse prej momentit kur është themeluar fabrika dhe ju keni nënshkruar kontratë ëtëherë bëhet fjalë bër fabrikë industriale. A është qmimi 5 cent apo 11 cent nuk prishë punë përderisa ekziston fabrika njërejt prodhojnë domate. Qështja e trëtë që e ceku Z. Kryetar pra për ujin e pijshëm, ju thatë që prej komunës nuk ka dalë asnjë cent mirëpo edhe dërmarrja që ka shpenzuar me mijëra euro nuk ka pasur kurrfarë suksesi sepse së fundi nuk ka ujë të pijshëm. Edhe në menaxhmentin e vjetër ka qenë e njëjta situatë. Ujë ka por nuk ka ujë të pijshëm. Kjo punë duhet të shkojmë në mënyrë sistematike dhe e programuar, së pari bëhen analizat mandej shtrohen gypat. Edhe ndërmarrja e ujit Radoniq ka dashur me na ndihmu edhe mjetet që kanë kërkuar nga ne jemi munduar ti sigurojmë përmes donacioneve të ndryshme pra kemi mundësi edhe prej vendeve tjera të marrim ujë por duhet me bërë më tepër presion. Faleminderit. Këtu ka shumë mangësi por me kusht që në të ardhmën të përmirësohen ne dot do ta votojmë këtë kornizë.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Ka dezinformata. Sa i përket ujit të pijshëm ndërmarrja me vetfinancim ka inicuar këtë punë, ne nuk kemi transferu mjete dhe rezultaten që i kanë nxjerrë ndërmarrja janë të nxjerra nga institucionet varëse të Kosovës. Sipas analizave te bëra nga institutit shëndetësor i kosovës uji i puseve të hapura në Mamushë është i pijshëm, është ujë më i mirë se i Radoniqit. A është gabim apo drejtë së fundmi është një raport që e kanë dhënë ata.

Necmedin Morina

Ilyasi qka tha është e drejtë, tani firma e ujit e ka përdorë emrin e Mamushës. Kur e ka bërë investimin Prizrenit i ka thënë që kam me kyq ujin e pijës në Mamushë.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Unë po tham që asnjë investim nuk e ka bërë në emër të komunës së Mamushës. Po thoni që ka marrë mjetë duke e përdorur Mamushën, jo nuk ka marrë mjetë nga askush sepse unë dy herë jamë takuar me shoqata që ofrojnë përkrahje për ujë por nuk më kanë ofruar asnjë përkrahje, pra deri më sot asaj ndërmarrje në emër të Mamushës nuk iu është dhënë asnjë cent. Ndërmarrja është e obliguar ti furnizojë qytetarët e kosovës, ligji ia obligon dhe sipas raporteve të institutit Shëndetësor të Kosovës uji është i pijshëm ndërsa sa është i mjaftueshëm mvaret nga keqpërdorimi i qytetarëve. Sa i përket bujqësive neve para dy viteve kemi nënshkruar marrëveshje me ndërmarrjen e petrolit shell që qdo bujku ti bëjë 5 cent zbritje në litër. Listën e kemi marrë nga shoqatat e bujqësive dhe bazuar në këtë listë e kemi nënshkruar marrëveshjen. Kanë kërkuar edhe listën e zyrtarëve komunal që të bëjë zbritje. Sa i përket bujqësive, ndoshta edhe hiq nuk kemi arritur me realizo diqka të mirë por në aspektin shëndetësor dhe në aspektin e bujqësisë unë personalisht po mendoj që kemi qenë të suksesshëm. A ka mangësi, ka, a ka nevojë për përmirësim, ka. Shumë mirë e dini që Komuna e Mamushës këto dy vitet e fundit ka qenë nëpër mediat e kosovës. Kur janë shkaktuar dëmet nga breshëri të nesërmen në Mamushë ka qenë ish kryeministri Albin Kurti mandej edhe Ministri i Bujqësisë, deputetë, zëvendër krueministrat. Në festival sado pak jemi munduar që përmes festivalit ti ndihmojmë buqit me pajisje bujqësore. Edhe këtë vit po presim që të miratohet buxheti nga qeveria dhe të dalim në tender me 2 traktora, 50 freza dhe 20 motokultivatora. Mangësia më e madhe është në Arsim. Niher i kemi shfrytëzu 400.000€ edhe 20 vende pune.

Halim Sadiku?

Duhet me shfrytëzu në favor të qytetarit. 3.000.000€ qka jen për qeverinë, a po don me ta votu qeverinë, po, atherë shumë punë e thjeshtë është bima ujin.

Nehat tac

Pse si ke bo ti qeto, qe 20 vjet e ki qevërinë, ti a i ki qu vota hashim thaqit, ja ke qu votat kadri veselit edhe ujë skena qe 20 vjet. Këto mundësi janë kon edhe përpëra me u shfrytëzu. Ti ke mujt me bo edhe edhe sen ske bo

Halim sadiku

U Shfrytëzu qdo sen. Prej ku të kanë ardhe ty krejt këto sene, prej qeverisë së Kosovës. Unë qka kum mujt me bo kum bo.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Siq e thashë edhe më herët Z. Halim në dy tri lëmi kemi pasur shumë sukses por në lëmi tjera kemi shumë mangësi. Cili është suksesi më i madhë i joni, Mamushën e kemi futur në /Kosovë, edhe ky është një sukses. Kemi marrë ndihma edhe nga turqia por ra pandemia dhe qdo plan e ka prishur. Autoambulanca është në Istanbul por nuk po kemi mundësi me e pru, ska qysh, gjëja që tani na duhet më së tepërm, përvëq kësaj ne kemi dalë në tender për me ble edhe një autoambulancë tjetër ku vitin e kaluar të gjithë së bashku kemi ndarë buxhet për këtë. Një autoambulancë nga turqia, një ne që do ta marrim plus edhe një e

kam kërkuar nga minisrtia e shëndetësisë. Tani për tani më shumë kemi nevojë për këtë lëm. Në qeverinë e vetëvendosjes nuk kemi mundur ndoshta me përfitë por në këtë qeveri prej 61 votave dhe prej tyre janë 3 deputetë turk dhe na mundemi me shkëput diqka prej saj. Mundemi me i qit kushte, jua votojmë buxhetin po që se na kyqni ujin e pijës në Mamushë. Psi që po jetojmë në kosovë duhet të shikojmë se si mund ta përfitojmë buxhetin e republikës së kosovës për ta zgjidhur problemin më të madh që e kemi niher për niher, pra problemin e ujit të pijshëm.

Ilyas Bayraktar

Înderuar Z. Kryetar, postimin per furnizim me ujë të pijshëm në Mamushë e keni bërë ju personalisht, ne u gjëzuam shumë dhe të përkrahëm. Kur ta shikojsh nga ana tjetër po investon 400.000€ në emër të Mamushës kurse rezultati zero. Kjo është vetëm arsyet Z. Kryetar, pa keqkuptime.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Ti po i përzin dy gjëra, po thu që shko dhe tregoji Kryeministrin se si të veprojë, unë nuk kam kompetenca me i tregu ndërmarrjes si me vepru. Unë i bëjë kërkësë ndërmarrjes që qytetarët e Komunës së Mamushës nuk kanë ujë të pijshëm, furnizomëni me ujë. Qysh dhe tek e bënë furnizimin, është përgjegjësia e saj. Ju lutem mos i përzieni gjërat. Ti ke drejtë vetëm më kérku ujë nga ndërmarrja, mandej i merr raportet e analizave për ujin që a është i pijshëm apo jo.

Ilyas Bayraktar

Uji është i pijshëm a po?

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Sipas raportit ujin që po mendojnë ta sjellin është i pijshëm.

Necmed'n Morina

Kryetari i Komunës ka kërkuar ujë të pijshëm dhe ky furnizim iu është dhënë ndërmarrjes licencuese Hidroregioni, por nëse kryetari i komunës nuk ka arritur me nënshkru marrëveshje atëherë nuk e sjellin ujin. Një ndërmarrje nëse nuk ka nënshkruar marrëveshje me kryetarin e komunës nuk mundet me pru ujë.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar i Komunës

Nuk kemi nevojë me nënshkru kurrfarë marrëveshje sepse jemi vartës të Hidroregionit. Nese nuk merr ti me pi ajo është tjetër problem. Sa i përket ujit të Radioniqt Ilyazi ka qenë në ngjarje shumë mirë.

Necmedin Morina

Halimi ka pas thënë që mbrenda 24 orëve kam me pru ujin e Radoniqt, ku është uji?

Halim sadiku

Me ilyazin jena kon bashkë. Prap pi ngatrrojmë senet, kena ardhë në pikën mat nevojshme edhe po debatohet më e nevojshmja që asht për qytetarin është uji, qekjo po lypet mu debatu mas shumti. Politika Z. Nehat është gjithqka, jeni politikë edhe duhet mu msu. Politika është arsimi, shkenca, mjeksia, krejt kto janë politikë. Pse duhet mu njerëzit në politikë jo hajna, normal duhet mu kon shumë të mire. Mjeku ta myt ni njeri, politikani mu kon i keq ta myt një popull, edhe kërkun mos me pas njerz të dijshëm në politikë duhet me pas shumë të dijshëm. Tash qka mujna na me përfitë prej politikës, nuk i kum leju me pas qasje partitë politikë qëndrore shqipatare në Mamushë për shkak se mu forcu komuniteti Turk edhe me shku atje edhe me votat e tyre na me përfitë, kur neve na kanë neglizhu ata partitë turke atje, unë zgjedhjet e fundit jam aktivizu për mi vetëdijësu, kum ndërhyn unë edhe kum marrë vota vetëm mi tregu atyre mi thon qkyrni, vetëdijësohuni, investoni për Mamushën se herën tjetër vetëdijësohet populli edhe

nuk mundeni me marrë asnjë votë. Zgjedhjet e fundit janë qeto që na kemi bo për partitë shqiptare. Qëllimi u kon me përfit që ky kur ti thot Mahir apo Fikrim neve na vyhet investimi uji na duhet kjo e ajo, ai atje me i kushtëzu senet. Qekjo është politika edhe pikërisht unë i kum pa që ata kanë ra në gjumë edhe pe shfryëzojnë Mamushën un jam qu edhe kum thon kadale se qetu votat kan me ju mungu edhe sikur që ju mungun përmi 900 vota edhe u përqëndru vëmendja kadale se kta po mujkan neve edhe me na rrux. Po qështu duhet me vepru krejt. Faleminderit.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të përdoruar anëvatë nëse nuk keni diqka me shtu atëherë votojmë per këtë pikë.

Me vota unanimë është votuar edhe kjo pikë.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i nënshkrimit të marrëveshjes së mirëkuptimit për strehimoren e Prizrenit

Abdülhadi Krasnic: Kryetar i Komunës

Ju e dini që kjo pikë ka kaluar përmes kuvendit por me ligj janë edhe disa procedura që duhen të ndiqen prë dubet tă nënshkruhet marrëveshia dhe ky nënshkrim duhet të votohet në kuvend.

Ruvar Mazrek

• La dilwach dicke me shtu lidhur me këtë pikë, nëse jo atëherë votojmë.

Momentu unopima kia pikä u. yötua

5 Tärendryshme

Buvar Mazrek:

Ajuz dëkush dëgja me shtu në të ndryshmet?

Halim Sadiku

Për qështjen e covidit ma shumë, uroj që të shërohen sa ma shpejtë edhe qeta që janë prek. Po ka ni sen që në Kosovë ka shumë thashethëme, nuk ka nevoj kërkush as mu idhnu as mu krenu, kjo është proces global. Unë i ni zhurmat banvaki ni qytetar e ka naj sebep edhe nuk guxon me dal në rrugë se meniher thojnë a e paska sebepi juj koronën a? Na mujna me pas krejt banvaki edhe e kemi pas edhe e kemi kalu pa e marrë vesh. Na skemi nevoj me nenqmu atë por kemi nevoj mi dhon moral atij, mi dhon fjalë miradije, pa marrë parasysh, vetëm kru i nin këto sene, tjetër kund jo, kjo është shumë normale, kjo është një grip qëbanvaki krejt njerzimi ka me kalu. Nuk ka nevojë me bo tragjike, unë pe shoh nëpër media, pe shoh shumë të madhe, pe shoh shumë keq, shumë gabim, pse gabim, sepse na jemi prodhues edhe kemi me dal neëpër të gjitha tregjet dhe nëse figuron që Mamusha dominon me covid ka me u ngurtësu ekonomia. Kështu që prej prej të gjithë juve, mos e bani këtë të madhe këtë punë, me qetësi ishalla e kalojmë edhe këtë proces edhe e vazhdojmë jetën normale, rujuni sat muni, mani distancë, mbani higjienë. Faleminderit.

Camil Mazrek:

Ju përshendes të gjithëve, unë desha me fol pak për QMF-në, kur po shkojnë qytetarët për vizitë mjekët që po i kontrollojnë mënjerët po e shkruajnë që ka covid. Me atë raport po shkojnë drejt për spital, diagnoza veq po është e gatshme. Si mundet me e përcaktu a ka apo nuk ka virus pa e bërë asnjë analizë. Edhe tek qështja e urës, sipas mendimit tim më mirë do te kishte qenë që hekuri te ndahet në dy pjesë dhe ura të jetë më e gjerë. Në lagjen tonë janë tri shtylla elektrike thuajse janë rrëzuar. Faleminderit.

Sevgi Mazrek:

Ju përshendes të gjithëve, sa i përket virusit në asnjë raport nuk shkruan që ka virus, veqse shkruhet dyshim për coronë. Pacientit së pari ia masim temperaturën dhe nëse ka temperaturë automatisht po të jep sinjal që duhet me e dërgu diku tjetër. Para 2 dite ka ardhur një pacient me traktor, temperatura 40, pas një ore ka ardhë me kërk u dhëzimin sepse e ka humbur, me orë të tëra është shëtitur me traktor. Qfarë një ore ka ardhë me kërk u dhëzimin sepse e ka humbur, me orë të tëra është shëtitur me traktor. Qfarë masash me ndërmarrë ndaj këtij rasti edhe na nuk po dijmë. Pastaj erdhi edhe një pacient tjetër, edhe atë e marrë privat tek mjeku Riza dhe ka marrë ingjekzion. Kemi udhëzuar për në spital, ai nga QMF-ja ka shkuar privat tek mjeku Riza dhe ka marrë ingjekzion. Gabimi më i madhë është tek ju kryetar, këni deklaru vet që në Mamushë nuk ka coronë, këtu iu është përzier koka qytetarëve.

Buyar Mazrek:

Ky virusi e ka një të keqe që testin po e bënë shembull sot kurse rezultatet po dalin pas një javë. Në këto ditë vere Mamushës nuk mundemi në asnjë mënyrë me e ndalë, shko në Prishtinë i ke 150 Mamushali, në prizren 100 e më tepër sepse tani është sezona. Edhe krejt Kosova me u qu në këmbë nuk mundet me e ndalë, mundesh po të kishe pasur buxhet me ia dhënë qdo bujku 50,000€. Edhe qka do që flitet rreth visurit është gjenjeshtër.

Sevgi Mazrek:

Një minut, ju a po besoni apo nuk po besoni që ekziston virusi?

Buyar Mazrek:

Ju jeni zyrtare e shëndetësisë dhe e dini fort mirë që këtë virus ne e kemi pasur edhe para 3 muajve, kanë qenë të sëmurë më shumë se 300 persona. Ne duhet të mësohem të jetojmë ke këtë grip, jeta po vazhdon.

Sevgi Mazrek

Unë jam e interesume me dit neve në QMF na kanë testuar dhe disa kanë rezultuar pozitivë, por a janë testuar edhe familjarët e tyre edhe sa familje janë testuar? Tani këto testimet që janë bërë për herë të dytë tek punëtorët e QMF-së të gjitha kanë rezultuar negativ vetëm një pozitiv, pozitivi prap karantinim kurse të tjerët nuk kanë karantinë, njëri pozitiv edhe tërë familja pozitiv, dje kanë thirrur dhe i kanë thënë pas tri dite fillojani punës, as familja nuk ka nevojë me u ritestu. Pres përgjigje për këtë.

Ilyas bayraktar

Inderuar kryesues, unë nuk po kuptoj juve qfarë detyre jeni duke ushtruar, nëse anëtraja e ka marrë fjalën lëreni le të shprehet, ju qka po qëndroni aty, njëherë po thoni ka virus prap po i ndërroni fjalët jo nuk ka. Apo besoni a po nuk po besoni që ka virus? Kur anëtarë e merr fjalën duhet me respekt. Ajo deshi me tregu diqka tjetër kurse ju e perceptuat krejt një gjë tjetër. Mundet me rezultu pozitiv, por si ka mundësi që pa bërë asnjë test Prishtina po i lejon me u kthy në vende puno ose me i liru nga karantina.

Buyar Mazrek:

Këtë nuk mundet me dit askush, as kryetari i komunës bile, unë po tham që inshallah askush nuk sprovohemi me këtë sepse as Ministri i shëndetësisë bile nuk mundet me e ditë.

Ilyas bayraktar

Ju po thoni që nuk ka virus

Buyar Mazrek:

Une Buyar Mazrek them që nuk ka virus.

Halim Sadiku

Unë jam pozitiv me corona virus, e kum kalu, a e keni marrë vesh jo, a u bo kjameti a?

Ilyas Bayra

Ju nuk po e di a po e vëreni por pleqtë po vdesin nga kjo sëmundje.

Bulvar Mazrek:

Buyar Mazrek. Edhe të rinjët po vdesin, ti a e din që vitin e kaluar kanë vdekur 40 persona kurse këtë vit 11 dhë jemi në muajinje 8të.

Muajime: İlyas Bayraktar

Illyas Bayraktar Të rinjët nëse nuk kanë ndonjë sëmundje kronike munden shumë lehtë me tejkalu, por ti nëse ke ndonjë sëmundje kronike atëherë ti vdesish. Për këtë arsyе duhet të ndërmirren masa që ti ruajmë të sëmuarit, të moshuarit, mos të bëhemë ne shkaktar për vdekjen e tyre. Nëse ka temperaturë, ethe, vështirësi në frymëmëarrje aëherë këto janë simptoma te virusit. Le të rrin personi në shtepi, mos të dal me rreziku edhe jetën e tjetrit.

Halim Sadiku

Unë jam pozitiv me corona virus, e kum kalu, a e keni marrë vesh jo, a u bo kjameti a?

Abdülhadi Krasnjic: Kryetar I Komunës.

Sa I përket koronavirusit unë dashta me I dhënë disa sqarime. Pasi që kemi marrë pyetje më herët po I përgjigjem me rend. Ura ka me qenë një drejtimëshë. Kthehemë tek korona virusi, virusi ekziston dhe njerëzit po vdesin, kjo nuk është një situatë normale ama siq e tha edhe Sevgia më herët askush në QMF nuk shkruan që ka virus, pa u testu. Testet mirren dërgohen në Prishtinë dhe në bazë të rezultateve vërtetohen a janë pozitiv apo negativë, ndërsa sa janë të sakta këto rezultate unë nuk mundem me ditë. Mua si kryetar komune vetëm mi dërgojnë të dhënat që në këtë ditë, me këtë datë janë marrë testet për x persona dhe x persona kanë rezultuar pozitivë, negativet nukna dërgojnë. Kohëve të fundit rastet pozitiv me virus kanë dalë vetëm tek pacientët që janë shumë të smëure që patjetër janë detyruar me shku tek mjeku. Të shumica është problem që janë munduar të marrin terapi në shtëpi, 3 -5 ditë. Mjekët në QMF-së nuk e përcaktojnë diagnozen përfundimtare por sipas simptova që I posedon pacienti dyshohet per virus edhe drejtoheni per ne infektiv ne Prizren. Ana pozitive është që njerëzit kanë filluar me kërkua qare për vreten, kanë filluar me shku në spital. QMF-ja e Mamushës I udhëzon si të dyshimtë për spital, pacienti nuk po shkon në spital por po shkon privat, mjeku privat nuk po ja jep për me shku me bo test por pi ja shkrun një terapi dhe me atë terapi prap po vjen në QMF, vendosma infuzionin, jepma një ingjekzion. Dyshimi jonë që nga këta pacientë po infektohen edhe stafi I QMF-së dhe shumica e të infektuarve në QMF nuk kanë simptomë, as temperaturë, as ethe. Por duhet të mbrohemë. Së fundmi pasi që ekspertët e OSHB-së po pranojnë që ka një pandemi të tillë atëherë edhe ne duhet ta pranojmë. Mua, të rinjëve ndoshta nuk na bënë asgjë por nëse në shtëpi kemi dikë të sëmurë ose të moshuar ata I mundon. Shikuar nga aspekti ekonomik ne 4 muaj kemi thënë që nuk ka coronavirus në Mamushë, kemi thënë jo sepse te askush nuk ka pasur simptomë dhe nuk kanë shkuan me bë teste edhe testet kanë filluar të bëhen kur patjetër jemi detyruar të shtrihemi në spital. Disa kanë tregu me kënd kanë pasur kontakte ndërsa disa nuk kanë deklaruar për askënd dhe këtu as komuna, as kryetari po asministri I shëndetësisë nuk kanë kompetenca për me I dërgu me forcë me I testu. Illyazi tha që të sjellim teste ose pajisje mjekësore nga Turqia jo sepse ti dhe unë dhe ne jemi banorë të republikës së Kosovës dhe duhet ti përshtatemi kushteve të Kosovës. Kemikëruar ndihma, na kanë ofruar pako oshqimore, pako higjenike. Nuk minden me na dërgu staf mjekësor ose teste.

Necmedin Morina:

A ban me ndërhy pak, Novi PAzari I Sërbisë është në gjëndje shumë të rëndë dhe përmes shoqatave ka hyjnë kontakt me Turqinë dhe iu janë ofruar shumë ndihma qoftë pako ushqimore, higjenike, maska, dezinfektues.

Abdülhadi Krasniç: Kryetar I Komunës.

Edhe neve afër 8 shoqata na kanë ofruar ndihma. Ne po dojmë që Turqia le tam merr një aeroplan, le ta mbush me pako qoftë ushqimore, higjenike, le ta mbush me barna dhe me staf mjekësor dhe le të zurret drejt në Mamushë, most a kqyr as kush është Kosova, kush janë Ministria e shëndetësisë. Nuk ka një gjë të tillë, ne jemi shtetas të kosovës, po jetojmë në Kosovë dhe duhet ti përbahemi kushteve dhe rregullave të saj.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Të nderuar anëtarë nëse nuk keni diqka me shtu në të ndryshmet atëherë mledhja ka përfunduar. Faleminderit për pjesmarje.

Proces mbajtësi
Idriz Mazrek

Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek
